

ОПШТИНА СТРУГА  
KOMUNALITETI STRUGËS

Br. 08-3270  
Nr.

18.11.2011

СТРУГА STRUGË

Ne, **Fuad Shishiq** dhe **Ramiz Merko**,

Kryetarë të komunave: **Teshanj**, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe **Strugë**, Maqedoni

Përfaqësues të zgjedhur me votën e lirë të qytetarëve tanë,

Të sigurtë se veprimet në emër të dëshirës të sigurtë dhe të nevojave reale të banorëve tanë,  
Të vetëdijshëm se në bazë të kulturës sonë dhe të njerëzve të komuniteteve të lirë, se shpirti i lirisë  
është në fakt themeli i lirisë që ata fituan dhe qeverisjet lokale i vendosën dhe i themeluan më vonë,  
Duke marrë parasysh se zhvillimi i një bote më të hapur është domosdoshmëri historike, por që kjo  
botë do të jetë me të vërtetë më njerëzore vetëm atëherë kur burrat dhe gratë do të jetojnë të lirë në  
qytetet e lira,

Të bindur në domosdoshmërinë e respektimit të parimit të subsidiaritetit,

Duke afirmuar vlerat tona të respektimit të të drejtave të njeriut të cilat nuk duhet të jenë të  
kërcënuara apo të mohuara,

Duke kuptuar se ndërvarësia në rritje të kombeve të ndryshme kërkon një rend ndërkombëtar, global  
dhe demokratik, si themel i paqes së vërtetë,

Të bindur se lidhjet që lidhin qytetet në kontinentin tonë paraqesin një element thelbësor në rrugën e  
zhvillimit dhe frymës Evropiane, duke promovuar në këtë mënyrë dimensionin njerëzor të Evropës

### SOT BETOHEMI SOLEMNISHT

Se duke u bazuar në marrëdhëniet që ekzistojnë mes dy vendeve tona,

Se do të ruajmë lidhjet e përhershme në mes të autoriteteve të dy pushteteve tona lokale me qëllim  
të nxitjes së dialogut, shkëmbimit të përvojave dhe zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta për të  
përshejtuar përparimin e përbashkët në të gjitha fushat nën juridiksionin tonë,

Se ne së bashku do t'i inkurajojmë dhe mbështesim shkëmbimet midis qytetarëve tanë e në këtë  
mënyrë zhvillimin, nëpërmjet të kuptuarit më të madh të ndërsjelltë dhe të bashkëpunimit efektiv, në  
frymën e vërtetë Evropiane drejt një ardhmërie të përbashkët,

Se do të veprimet në përputhje me parimet e miqësisë, duke respektuar dhe pranuar dallimet tona  
në një atmosferë të mirëbesimit dhe të solidaritetit,

Se do tu garantojmë të gjithë qytetarëve mundësinë për të marrë pjesë në shkëmbimit e të dy  
qyteteve,


Se nëpërmjet shkëmbimeve dhe formave të tjera të bashkëpunimit, të promovojmë vlerat universale  
të lirisë, demokracisë, barazisë dhe sundimit të ligjit,

Se do t'i shfrytëzojmë të gjitha mjetet në dispozicion dhe përpjekjet t'i orientojmë drejt sigurimit të  
mbështetjes të kësaj ndërmarrje të rëndësishme me qëllim të përparimit, paqes dhe prosperitetit siç  
është:

### BASHKIMI EVROPIAN.

**Fuad SHISHIQ**

Kryetar i Komunës Teshanj



Vendi: Strugë

Data: 19/11/2011

**Ramiz MERKO**

Kryetar i Komunës së Strugës

